




REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	2-D/DPK
Nr. i faq. Broj stranica Nr. pages	03
Nr Prot. Br Prot Prot No	01-2595/13
Data Datum Date	29-08-2013
PRISHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 27.08.2013, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr.AKK- 03-13/13,për Zyrtarin e Lartë, z. Tasim Gubetini, Këshilltar Komunal ne Kuvendit Komunal në Vushtrri, për shkak se Zyrtari i Lartë ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit në të cilën ndodhej, pasi qe ka dhen dorëheqje nga funksioni Publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të mundshëm të interesit është zhvilluar procedura e paraparë sipas nenit 18.2 te ligjit Nr.04/L-051,Per Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Pas informatës se marrë ka filluar shqyrtimi i lëndës me numër protokolli AKK-03-13/13, që për trajtim ka pasur Zyrtarin e Lartë, z.Tasim Gubetini, Këshilltar Komunal në Kuvendin Komunal në Vushtrri.

Gjate zhvillimit të procedurës dhe analizimit të gjendjes është konstatuar se zyrtari i lartë, gjatë kohës se ushtrimit të funksionit publik si, Këshilltar Komunal në Kuvendin Komunal në Vushtrri, është duke ushtruar edhe një funksionin ne një biznes private si “Supervajzer” (Udhëheqës i Nëndegës se Bankës për Biznes ne Vushtrri), e që sipas Ligjit për parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L-051, kjo situatë ka paraqitur konflikt të mundshëm të interesit, dhe mos pajtueshmëri ne ushtrimin e funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit me datën 19.02.2013, e ka njoftuar zyrtarin e Lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejte në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet qe posedon Agjencia.

Pas këtyre procedurave, z.Tasim Gubetini, Këshilltar Komunal ne Kuvendin Komunal në Vushtrri, pasi ka kontaktuar me zyrtaret e Agjencisë ka kërkuar një takim për ta sqaruar situatën, e dyshuar.

Zyrtaret e agjencisë e kanë organizuar një takim me z.Gubetini i cili është mbajtur me datën 04.03.2013 ne zyrat e Agjencisë kundër Korrupsionit, dhe zyrtarit i janë prezantuar faktet qe posedon Agjencia, lidhur me konfliktin e mundshëm të interesit, gjatë takimit z.Gubetini është pajtuar për situatën ne te cilën ndodhet, miro po është arsyetuar se nuk ka qenë informuar për këtë, pasi qe nuk e ka informuar as kush qe nga momenti i zgjedhjes si, këshilltar komunal ne Kuvendin komunal te Vushtrrisë, dhe nuk ka pas njohuri për këtë situatë qe mundë te shkaktoj Konflikt të mundshëm të Interesit dhe mos pajtueshmëri ne ushtrimin e funksionit publik.

z.Tasim Gubetini, Këshilltar Komunal ne Kuvendin Komunal ne Vushtrri, gjatë këtij takimi është zotuar se pasi te konsultohet me partine dhe te marr informata shtesë do te veproj sipas ligjeve ne fuqi dhe ne afatin ligjor do te do ta marr hapa konkret për te shmang situatën e mundshme të Konfliktit të Interesit.

Agjencia kundër Korrupsionit me datën 23.04.2013 z. Tasim Gubetini i ka dërguar njoftimin e dyte paralajmërues për konstatimin e gjendje se Konfliktit te Interesit ne ushtrimin e funksionit publik, pasi qe nuk ka ndërmarrë asnjë hape për ta shmange Konfliktin e Interesit pas njoftimit të pare, dhe e ka njoftuar se ushtrimi i aktivitetit privat si mbikëqyrës (Supervajzer) në Bankën për Biznes bie ndesh me funksionit publik si Këshilltar Komunal në Komunën e Vushtrrisë, të para parë si pas nenit 15.1 dhe 16.1 të Ligjit Nr. 04/L-051, Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit ne Ushtrimin e Funksionit Publik.

Andaj ka kërkuar nga aj qe që ti ndërmerr të gjitha hapat për shmangien e gjendjës së konfliktit të interesit brenda afatit 15 ditor.

Me datën 07.06.2013, Zyrtari i Lartë z. Tasim Gubetini, Këshilltar Komunal ne Kuvendin Komunal ne Vushtrri, ka sjellë dëshminë se i ka ber kërkesën Kuvendit Komunal ne Vushtrri se ka vendosur te tërhiqet nga pozita Këshilltar Komunal ne Kuvendin Komunal ne Vushtrri, pasi qe është ne mardhenje pune ne Bankën për Biznes dhe e ka te pa mundur qe njëkohësisht të kryej edhe funksionin e Këshilltarit Komunal ne Kuvendin Komunal në Vushtrri, pasi qe bie ndesh me ligjin Nr.04/L-051,Per Parandalimin e Konfliktit te Interesit ne Ushtrimin e Funksionit Publik.

Agjencia kundër Korrupsionit ka përcjellë ecurinë deri sa është njoftuar zyrtarisht nga Kuvendi Komunal ne Vushtrri se z.Tasim Gubetini, ka dhen dorëheqje nga pozita e Këshilltarit Komunal ne Vushtrri.

Andaj konsiderojmë se zyrtari i larte z. Tasim Gubetini, pasi ka dhënë dorëheqje nga pozita zyrtare ka shmangur gjendjen e mundshme te Konfliktit te Interesit ne te cilën ndodhej

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Hasan Preteni
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

